



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .12.2020

**Për mbledhjen Nr. 51, datë 15.12.2020, ora 10:00
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e martë, datë 15.12.2020, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 51 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” për licencim në veprimtarinë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike
- 2- Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE
- 3- Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 199, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE
- 4- Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 200, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE
- 5- Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE
- 6- Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh. a, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetë vjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.
- 7- Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 201, datë 03.09.2018, për miratimin e “Planit të masave për operatorin e shpërndarjes të energjisë elektrike ‘OSHEE’ sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”
- 8- Mbi fillimin e procedurës për miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit

9- Mbi miratimin e udhëzimit për procedurat dhe afatet e kryerjes së monitorimeve nga Enti Rregullator i Energjisë

10- Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit

11- Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI